QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË

Edicion Special:

Perceptimet e Publikut për Politikën e Jashtme dhe Dialogun me Serbinë

Shkurt 2016

BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË

Edicion Special:

Perceptimet e Publikut për Politikën e Jashtme dhe Dialogun me Serbinë

Shkurt 2016

Botues: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Projekti u mbështet nga: National Endowment for Democracy

Interpretuese e të dhënave: Donika Emini

Redaktimi i brendshëm: Florian Qehaja

Redaktimi profesional: Shpend Kursani

Shënim: Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën angleze.

© Të gjitha të drejtat e rezervuara për Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë. Ligji mbi të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta dhe pronës intelektuale.

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes apo të transmetohet, në asnjë formë apo me asnjë mjet elektronik, mekanik apo tjetër, pa lejen me shkrim nga botuesi. Përdorimi komercial i të gjitha raporteve të publikuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), nuk është e lejuar pa pëlqimin me shkrim të QKSS. Ju lutem kontaktoni: info@qkss.org ose +381 38 221 420.

Perceptimet e prezantuara në këtë raport janë përmbledhje e informatave të grumbulluara nga të anketuarit dhe demonstron vetëm atë sesi njerëzit i perceptojnë institucionet. Në asnjë mënyrë nuk është një vlerësim përfundues i cilësisë së punës së institucioneve që janë objekt i këtij studimi. Do të shërbejë si një instrument për ta për të adresuar mangësitë e mundshme, por gjithashtu si një indikator i efikasitetit të komunikimit të tyre me popullin.

Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë perceptimet e të anketuarve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë. Mendimet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e National Endowment for Democracy (NKD).

PËRMBAJTJA

ÇKA ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË? 7

KUJT I DREJTOHEMI ME KËTË EDICION SPECIAL? 7

NDIKIMI 7

METODOLOGJIA 8

HYRJE 9

GJETJET KRYESORE 9

KAPITULLI I 11

1. PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ SHTETEVE RELEVANTE RAJONALE 11

1.1. Perceptimet e publikut ndaj Shqipërise dhe Serbisë 11

1.2. Perceptimet e publikut ndaj Maqedonisë dhe Malit të Zi 13

KAPITULLI II 15

2. PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ "FUQIVE TË MËDHA" 15

2.1. Perceptimet e publikut ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Gjermanisë 15

2.2. Perceptimet e publikut ndaj Mbretësisë së Bashkuar dhe Turqisë 17

2.3. Perceptimet e Publikut ndaj Francës dhe Italisë 18

2.4. Perceptimet e publikut ndaj Rusisë dhe Kinës 19

KAPITULLI III 21

3. PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE DHE PERSPEKTIVA EURO-ATLANTIKE E KOSOVËS 21

3.1. Perceptimet e publikut ndaj NATO-s, BE-së dhe OKB-së 21

3.2. Perceptimet e publikut ndaj partnerëve potencial strategjik të Kosovës 22

3.3. Perceptimet e publikut ndaj anëtarësimit të Kosovës në BE 23

3.4. Perceptimet e publikut ndaj anëtarësimit në NATO 25

KAPITULLI IV 27

4. PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ DIALOGUT POLITIK ME SERBINË 27

4.1. Dialogu politik në mes të Kosovës dhe Serbisë: Kush është fituesi? 27

4.2. (Mos) arritja e normalizimit 29

4.3. Perceptimet e publikut për krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe 30

REFERENCAT 33

Falemnderim 34

LISTA E FIGURAVE

FIGURA 1 PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ SHQIPËRISË DHE SERBISË....13
FIGURA2 PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ MAQEDONISË DHE MALIT TË ZI....14
FIGURA3 PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ SHBA-SË DHE GJERMANISË....16
FIGURA 4 PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ MBRETËSISË SË BASHKUAR DHE TURQISË....18
FIGURA 5 PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ FRANCËS DHE ITALISË....19
FIGURA 6 PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ RUSISË DHE KINËS....20
FIGURA 7 PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ NATO-S, BE-SË, DHE OKB-SË....22
FIGURA 8 PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ PARTNERËVE STRATEGJIK PËR KOSOVËN....23
FIGURA 9 PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ ANËTARËSIMIT TË KOSOVËS NË BE....24
FFIGURA 10 PERCEPTIMET E PUBLIKUT PËR QASJEN E BE-SË NDAJ KOSOVËS....25
FIGURA 11 PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ ANËTARËSIMIT TË KOSOVËS NË NATO....26
FIGURA 12 PERCEPTIMET E PUBLIKUT PËR REZULTATIN E DIALOGUT NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË....28
FIGURE 13 PERCEPTIMET E SHQIPTARËVE DHE SERBËVE PËR REZULTATIN E DIALOGUT NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË....29
FIGURA 14 PERCEPTIMET E PUBLIKUN PËR NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË....30
FIGURA 15 PERCEPTIMET E SHQIPTARËVE DHE SERBËVE PËR NORMALIZIIN E MARRËDHËNIEVE NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË....30
FIGURA 16 PERCEPTIMET E PUBLIKUT PËR KRIJIMIN E ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE....32
FIGURA 17 PERCEPTIMET E SHQIPTARËVE DHE SERBËVE PËR KRIJIMIN E ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE....32

ÇKA ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?

Barometri Kosovar i Sigurisë (BKS) është një program specifik i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë i hartuar për të shërbyer si një publikim vjetor. Fokusi primar i BKS është të matë perceptimet e opinionit publik drejt institucioneve të sigurisë. Ky program gjithashtu matë perceptimin publik mbi kërcënimet e brendshme dhe të jashtme të sigurisë së Kosovës. BKS shënon njërën nga iniciativat më të mëdha dhe madje të parën të hartuar, të implementuar dhe të komunikuar nga një organ lokal këshillëdhënës në Kosovë. QKSS nuk ka asnjë detyrim politik në komunikimin e të gjeturave dhe të mesazheve. Në fund, BKS është unik në qasjen metodologjike, siç është adaptimi i metodave kuantitative dhe kualitative që ka për qëllim të ofrojë rezultate realiste mbi perceptimin publik drejt çështjeve të lidhura me sigurinë.

KUJT I DREJTOHEMI ME KËTË EDICION SPECIAL?

Ky edicion special i BKS-së synon një shumëllojshmëri të gjerë të palëve të interesuara për të ndjekur perceptimin e opinionit publik në Kosovë kundrejt partnerëve kyç strategjik në nivelin rajonal dhe ndërkombëtarë. Më konkretisht ky edicion i drejtohet një grupi audience të interesuar për të ndjekur trendet e opinionit publik në Kosovë, duke u përqendruar në politikën e jashtme të Kosovës, bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe nëdialogun me Serbinë. Në përgjithësi, BKS-ja targeton hartuesit e politikave; praninë e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë; organizatat lokale, rajonale dhe ndërkombëtare të shoqërisë civile; akademitë, si dhe mediat.

NDIKIMI

Ndikimi i BKS-së pritet që të shumëfishohet në një periudhë afatmesme duke pasur parasysh këta indikatorë: (a) rritja e vazhdueshme e besueshmërisë ndaj QKSS-së si një organizatë profesionale e pavarur dhe pa prapavijë politike, (b) përvoja e gjatë e QKSS-së në zbatimin e metodave të duhura shkencore në hulumtimet e veta, (c) nevoja për fuqizimin e rolit të ekspertizës vendore; si dhe (b) resurset profesionale që QKSS disponon.

METODOLOGJIA

Ky edicion special i BKS-së reflekton një përmbledhje të perceptimeve të qytetarëve për politikën e jashtme të Kosovës, partnerët strategjik rajonal dhe ndërkombëtarë, dhe dialogu me Serbinë. Për më tepër, lejon intepretuesit e të dhënave të dekonstruktojnë thellë Perceptimet e qytetarëve. Interpretimi reflekton mbi grupin e faktorëve politik dhe shoqërorë të cilat kanë ndikuar në formësimin e mendimit të të anketuarve. Dekonstruksioni i opinionit është i bazuar në përfshirjen e drejtpërdrejtë të interpretuesit të të dhënave në intervistat e drejtëpërdrejta me të anketuarit. Gjithashtu, grupet e fokusit me hulumtuesit në terren të cilët kanë mbështetur përpjekjet e ekipit të QKSS në dekonstruktimindhe analizimin e mëtejshëm të opinioneve që përmban ky edicion.

Përgjigjet në pyetësorin e BKS janë mbledhur me anë të intervistimit të drejtpërdrejtë që është kryer në tërë Kosovën. Shumica e pyetjeve ishin të mbyllura në formën pesë pikëshe të shkallëssë Likertit. Disa pyetje ishin të hapura që ua jepnin të anketuarve një mundësi të japin mendimin e tyre pa opsione të paradefinuara. Mostrimi, pilotimi dhe intervistimi janë bërë nga ekipi i QKSS ipërbërë nga 35 hulumtues të terrenit. Mostra kombëtare nga i cili u hartua hulumtimi, përmbante 1,070 amvisëri, duke ndjekur një mostër reprezentative të popullatës mbi moshën 18 vjeçare në Kosovë. Ndarja etnike e të anketuarve ishte: 88.4 përqind shqiptar të Kosovës, 7.7 përqind serbtë Kosovës, dhe 3.9 të tjerë (nga ta, 1.4 përqind turq, 0.6 boshnjak, 1.0 përqind RAE dhe të tjerët përfshijnë goranë, kroatë dhe malazezë).

Korniza e mostrës ishte e bazuar mbi kodet telefonike të rajoneve, e cila ka përfshirë 7 rajonet në vijim: Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren. Faza e parë e grupimit gjeografik është bazuar në Raportin e Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2012 të Kosovës, faza e dytë përfshinë grupimin e mostrave sipas zonave komunale me mostër të stratifikuar fshat/qytet sipas numrit të familjeve. Faza e fundit ndjek metodën e mostrës së rastit duke shfrytëzuar 'metodën e ditëlindjes më të afërt. Mostrimi i rastit siguron që secili banor në Kosovë të ketë një qasë të barabartë për t u zgjedhur për një intervistë. Me mostrën e përdorur për këtë studim, rezultati i projektit të hulumtimit, pasqyron imazhin e trendëve në qëndrime dhe perceptime, në mesin e tërë popullatës së rritur në Kosovë në përgjithësi. Margjina e gabimit është 3 përqind me një interval të konfidencës prej 95 përqind.

Para fillimit të punës në terren, një pilot intervistë u realizua në fillim të tetorit 2015, për të testuar realizueshmërinë e pyetësorit. Ekipi hulumtues më pas raportoi se pilot intervista ishte e suksesshme, dhe nuk është hasur në probleme me pyetjet e bëra të

anketuarve. Të gjitha intervistat janë kryer nga 21 deri më 29 tetor 2015. Përpunimit i të dhënave dhe analiza janë bërë duke përdorur softuerin SPSS.

HYRJE

Kapitulli mbi bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar ka qenë një pjesë integrale e BKS-së që nga fillet e këtij programi. QKSS ka konsideruar të nevojshme të lansojë edicionin special dhe të vazhdojë punën duke identifikuar tendencat në perceptimet e publikut drejt shteteve më relevante dhe organizatave ndërkombëtare, të cilat janë gjithashtu një çështje me interes për Kosovën. Tendencat e vazhdueshme të krijimit të marrëdhënieve bilaterale dhe multilaterale, marrëdhëniet me vendet fqinje, si dhe ngjarjet që po ndodhin në dialogun Kosovë-Serbi mbeten çështjet kryesore të analizës në këtë edicion.

Për më tepër, ky publikim shënon edicionin e dytë special me fokus të veçantë në politikën e jashtme të Kosovës dhe dialogun me Serbinë. Ky edicion special i KSB synon të ofrojë një pasqyrë të detajuar të perceptimeve të qytetarëve ndaj shteteve dhe organizatave relevante ndërkombëtare, duke përfshirë ato që janë të pranishme me misione aktive në Kosovë. Ky edicion, gjithashtu, do të manifestojë perceptimet e qytetarëve për akterët rajonalë dhe ndërkombëtarë, përfshirë pozicionimin kundrejt vendeve fqinje. Krahasuar me edicionin e parë, ky publikim do të sjellë një listë të re të çështjeve që kanë të bëjnë me dialogun politik me Serbinë, veçanërisht marrëveshjet që janë arritur gjatë vitit 2015.

Së këtejmi, edicioni special I trajton dimensionet e mëposhtme:

- Perceptimet e publikut ndaj akterëve relevante rajonale dhe ndërkombëtare;
- Perceptimet e publikut ndaj organizatave ndërkombëtare, proceset e integrimit euro-atlantik dhe partneriteteve të tjera të mundshme strategjike;
- Perceptimet e publikut kundrejt dialogut politik me Serbinë

GJETJET KRYESORE

Kyedicion special i BKS reflekton mbi perceptimet e qytetarëve ndaj politikës së jashtme të Kosovës, partnerët strategjik në nivel rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe dialogun me Serbinë. Tendencat e vazhdueshme të krijimit të marrëdhënieve bilaterale dhe

multilaterale, marrëdhëniet me vendet fqinje, si dhe ngjarjet që po ndodhin në dialogun Kosovë-Serbi janë çështjet kryesore të analizës në këtë edicion. Interpretimi reflekton mbi grupin e faktorëve politik dhe shoqërorë të cilat kanë ndikuar në formësimin e opinionit të të anketuarve.

Trendet e përgjithshme tregojnë se të anketuarit ndajnë perceptime të ndryshme dhe mjaft të dallueshme ndaj Shqipërisë dhe Serbisë. Gjetjet tregojnë se Shqipëria perceptohet si shteti më aleat ndaj Kosovës nga mbi 90 për qind e të anketuarve. Serbia në anën tjetër është listuar si shteti më armiqësor ndaj Kosovës nga 90 për qind e të anketuarve. Ndërsa pozicionimi ndaj Shqipërisë dhe Serbisë është shumë i qartë, perceptime të përziera ka për dy vendet tjera fqinje të Kosovës, respektivisht, Mali i Zi dhe Maqedonia. Pothuajse gjysma e të anketuarve perceptojnë këto dy vende si neutrale ndaj Kosovës.

Shtetet perëndimore, kryesisht SHBA dhe Gjermania mbeten aleatë më të mëdha të Kosovës në arenën ndërkombëtare, këto shtete gjithashtu shihen si partnerët kryesorë në procesin e shtetndërtimit të Kosovës. Nga ana tjetër, Turqia është duke u perceptuar si një aleat i ri të mundshëm, nga një pjesë e madhe e kosovarëve të cilët besojnë që Kosova duhet të forcojë partneritetin edhe më tej me Turqinë.

Qytetarët e Kosovës ndajnë perceptime pozitive në raport me procesin e integrimit në BE dhe NATO duke treguar në qartazi një nivel të madh të entuziazmit dhe gatishmërisë për t'u bashkuar me strukturat e tilla. Nga ana tjetër, një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve besojnë se BE-ja nuk ka një qasje konstruktive ndaj Kosovës. Një ekzaminim i afërt i rezultateve tregon se diferenca mes anëtarësimit në BE, të partneritetit strategjik me SHBA, dhe Turqisë është mjaft e vogël në sytë e të anketuarve. Si rrjedhojë, dështimi për anëtarësi ose për të vendosur marrëdhënie të mira me një nga subjektet e sipërpërmendura, kalimi në opsionet e tjera mund të jetë një alternativë më e lehtë.

Gati pesë vite pas fillimit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, si në nivelin teknik dhe politik, ky proces afatgjatë dhe i vështirë ka nxitur shumë debate të nxehta në mesin e elitës politike dhe qytetarët e Kosovës. Në këtë drejtim, pothuajse gjysma e të anketuarve besojnë se Serbia po përfiton më shumë se Kosova prej këtij procesi duke iu referuar proceseve të integrimit në BE për të dy shtetet. Ngjashëm, pjesa më e madhe e të anketuarve besojnë se dialogu po dështon për të arritur qëllimin gjithëpërfshirës - normalizimin e vërtetë të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë.

Rezultatet tregojnë se mendimet ndaj çështjes që ka nxitur debat të nxehtë në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi, krijimi i të Asociacionit të Komunave me shumicë serbe, është perceptuar negativisht nga një pjesë e madhe e të anketuarve. Një numër i madh i të anketuarve, ose mbi 70 për qind e tyre kanë treguar qëndrim negativ sa i përket krijimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe duke parë atë si shumë të dëmshme dhe të dëmshme për Kosovën.

KAPITULLI I

1. PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ SHTETEVE RELEVANTE RAJONALE

Lista e shteteve rajonale që janë vlerësuar në sondazhin e QKSS-së ka mbetur e pandryshuar nga edicionet e mëparshme. Kjo listë përfshin shtetet fqinje të Kosovës, të tilla si Shqipëria, Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi. Të anketuarit janë pyetur të vlerësojnë marrëdhëniet dhe qëndrimin e këtyre vendeve ndaj Kosovës duke filluar nga shkallët negative të tilla si shumë armiqësor, armiqësor, duke vazhduar me shkallë neutrale, dhe shkallët pozitive me miqësore dhe shumë miqësore. Është e një rëndësie të veçantë të përmendet që kur u pyetën në lidhje me shtetet e rajonit të anketuarit kanë formësuar mendimin bazuar në përvojën e tyre personale dhe opinioneve të krijuara me kalimin e kohës, ndërsa e njëjta nuk vlen për shtetet e tjera jo-rajonale, siç do të shtjellohet më tej në seksionin tjetër. Shtetet janë të grupuara në një mënyrë që të pasqyrojë gjetjet kryesore të këtij raporti, duke filluar me shtetet që kanë marrëdhënie më të forta dhe intense me Kosovën, siç Shqipëria dhe Serbia, dhe vazhdon me dy vendet e tjera fqinje, për të cilat të anketuarit duket të ketë mendime neutrale

1.1. Perceptimet e publikut ndaj Shqipërise dhe Serbisë

Në përgjithësi, të anketuarit e KSB-së ndajnë perceptime të ndryshme dhe mjaft të dallueshme ndaj Shqipërisë dhe Serbisë, si dy prej katër vendeve fqinje. Siç tregohet në Figurën 1, të anketuarit ndajnë perceptim kryesisht pozitiv ndaj Shqipërisë. Në të kundërtën, dhe gjithsesi e pritshme, perceptimet ndaj Serbisë mbeten negative me një rritje të lehtë të opinionit negativ në krahasim me rezultatet e KSB-së së vitit 2014.

Sa i përket Shqipërisë, 94.6 për qind e të anketuarve e konsiderojnë Shqipërinë si një fqinj miqësor, duke renditur atë si partnerin më të madh të Kosovës në rajon, ndërsa vetëm 2.2 për qind e të anketuarve kanë konsideruar Shqipërinë të jetë si një fqinj armiqësorë. Ndërsa, 2.2 për qind e të anketuarve kanë zgjedhur të mbetet neutrale në pikëpamjet e tyre ndaj Shqipërisë. Një përqindje jo shumë e madhe e trendeve neutrale ose negative kryesisht shihet si rrjedhim i disa të anketuarve të komunitetit serb në Kosovë.

Perceptimet pozitive ndaj Shqipërisë mund të shpjegohen nga një numër i madh i faktorëve, të cilat nxiten kryesisht nga vlerat e përbashkëta tradicionale, kombëtare, kul-

turore dhe historike. Për më tepër, rritja e mobilitetit në mes të qytetarëve nga Kosova dhe Shqipëria mund të thuhet se ka nxitur edhe më tej trendin e opinionit pozitiv në mesin e të anketuarve. Për më tepër, aktivitetet dhe ngjarjet e përbashkëta kulturore kanë luajtur një rol të rëndësishëm në formësimin e perceptimit ndaj Shqipërisë.

Rritja e lehtë e mendimit pozitiv ndaj Shqipërisë, në krahasim me edicionin e mëparshëm të BSK-së, ka qenë gjithashtu i nxitur nga faktorët politik, më saktësisht nga qasja proaktive e Shqipërisë kundrejt pavarësisë së Kosovës në arenën ndërkombëtare. Roli kryesues i Shqipërisë, diskursi politik i udhëheqësve shqiptarë që kanë treguar mbështetje në iniciativat e shumta rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe qëndrimi i fortë në mbështetje të pavarësisë së Kosovës në arenën ndërkombëtare u rendit si nga faktorët kryesorë prapa qasjes pozitive ndaj Shqipërisë.

Përderisa perceptimi pozitiv ndaj Shqipërisë vazhdon të shënojë rritje, e kundërta duket të jetë rasti ndaj Serbisë. Në sytë e të anketuarve shqiptarë të Kosovës, Serbia vazhdon të perceptohet si një shtet shumë armiqësor. Qartazi, perceptimet ndaj Serbisë janë të ndara në mënyrë të prerë me dallime të mëdha midis të anketuarve shqiptarë nga ata serb. Për shembull, 90.4 për qind e të anketuarve besojnë se Serbia ka qasje shumë armiqësore ndaj Kosovës; mendimet negative për Serbinë kanë shënuar rritje të lehtë në krahasim me edicionin e mëparshëm të KSB-së. Vetëm 3 për qind e të anketuarve mendojnë se Serbia është neutral, ndërsa një përqindje shumë e vogël e të anketuarve, ose 5.1 për qind, kanë listuar Serbinë si një vend miqësor ndaj Kosovës.

Me sa duket, mendimi negativ i të anketuarve shqiptarëve të Kosovës që manifestohet ndaj Serbisë është ende duke u ndikuar jo vetëm nga kujtesa historike e konfliktit dhe shtypjes, por edhe si rezultat i rolit destruktiv të Serbisë ndaj shtetësisë së Kosovës dhe diskursit në vazhdim. Dështimi për të dëshmuar rezultate të prekshme nga dialogu Kosovë-Serbi, qasja e pandryshuar e Serbisë ndaj shtetësisë së Kosovës, dhe rritjes së pakënaqësisë me marrëveshjet e arritura në mes të Kosovës dhe Serbisë, veçanërisht ai për themelimin e Asociacionit të Komunave Serbe ka ushqyer më tej pesimizmin ndaj Serbisë. Për më tepër, rezultatet e Barometrit Kosovar të Sigurisë 2015 tregojnë që Serbia vazhdon të perceptohet si kërcënimi më i madh të jashtëm ndaj sigurisë në Kosovë; rreth 66 për qind e të anketuarve ende e shohin Serbinë si një kërcënim sigurie ndaj Kosovës dhe qytetarëve të saj (KSB 2015, f. 24).

Në këtë drejtim, të anketuarit serb, duke përfshirë të anketuarit në pjesën veriore të Kosovës, kanë dhënë mendimin e tyre mbi qasjen e Serbisë ndaj Kosovës, duke treguar kështu një ndarje të qartë në mes të Serbisë dhe Kosovës. Ky, pra, është një pranim gradual i realitetit faktik të ekzistimit të Kosovës si shtet, dhe realitetin e tyre që jetojnë në Kosovë.

FIGURA 1 PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ SHQIPËRISË DHE SERBISË



1.2. Perceptimet e publikut ndaj Maqedonisë dhe Malit të Zi

Ndërsa perceptimet publike ndaj Shqipërisë dhe Serbisë janë qartazi të ndryshme në mesin e të anketuarve, mendimet ndaj Maqedonisë dhe Malit të Zi, si dy vende të tjera fqinje është mjaft i përzier me një tendencë të të anketuarve që të pozicionojnë mendimet e tyre ndaj të dyja vendeve në territor neutral.

Mesatarisht, Maqedonia shihet si shtet neutral ndaj Kosovës nga 45.0 për qind e të anketuarve, ndërsa 31.4 për qind kanë ndarë mendim pozitiv në lidhje me të, dhe 5.7 kanë parë Maqedoninë si një fqinj shumë miqësor ndaj Kosovës. Trendi negativ ndaj Maqedonisë është relativisht i ulët, me 19.6 për qind të të anketuarve të cilët kanë renditur atë si shtet armiqësor. Hulumtuesit në terren kanë vërejtur aftësinë e të anketuarve për të bërë dallimin midis shtetit të Maqedonisë me komunitetin shqiptar që jeton në Maqedoni.

Meqë opinioni publik dhe perceptimet janë kryesisht të shtyra nga politika ditore, mendimi i përgjithshëm pozitiv dhe neutral ndaj Maqedonisë do të mund të jetë formuar nga fakti se, për dallim nga Serbia, Maqedonia e ka njohur Kosovën. Përveç kësaj, duket se bashkëpunimi i shëndoshë ekonomik dhe liria e lëvizjes kanë rritur më tej qëndrimin pozitiv. Mbi të gjitha këto faktorë qëndrojnë edhe lidhjet e ngushta të shqiptarëve të Kosovës me komunitetin shqiptar në Maqedoni. Të anketuarit që kanë zgjedhur alternativën neutrale ose armiqësore kundrejt Maqedonisë i janë referuar trajtimit të padrejtë të komunitetit shqiptar në Maqedoni, dhe përleshjeve në Kumanovë në maj 2015.

Ngjashëm me rastin e Maqedonisë, pothuajse gjysma e të anketuarve, ose 49.2 për qind e kanë cilësuar Malin e Zi si një shtet neutral ndaj Kosovës. Gjysma e të anketuarve nuk e perceptojnë Malin e Zi si një shtet mik në vetvete, edhe pse as nuk ndajnë pikëpamje armiqësore qëndrim ndaj tij. Një pjesë tjetër, apo 33.7 për qind besojnë se qëndrimi i Malit të Zi ndaj Kosovës është mjaft pozitiv, ndërsa 15.8 konsiderojnë Malin e Zi si një shtet armiqësor ndaj Kosovës.

Trendi i butë dhe pozitiv drejt Malit të Zi është i shtyrë kryesisht nga qëndrimet politike që ky vend fqinj e ka marrë në drejtim të pavarësisë së Kosovës. Akti i njohjes ka shënuar një kthesë diplomatike e cila në qartazi tregon mbështetje për Kosovën, ndërkohë ka lënë në hije perceptimin historik të lidhshmërisë midis Serbisë dhe Malit të Zi. Për më tepër, ekzistenca e një komuniteti shqiptar në Mal të Zi dhe liria e lëvizjes në mes të Malit të Zi dhe Kosovës kanë kontribuar edhe më tej në qëndrimin e butë në mesin e të anketuarve ndaj Malit të Zi.

Qëndrimi negativ, nga ana tjetër, i atribuohet kryesisht ngjarjeve të fundit politike, që kanë të bëjnë me demarkacionin e kufirit ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi. Negociatat në lidhje me demarkacionin e kufirit kanë filluar në vitin 2012, megjithatë, vetëm në vitin 2015, kur Komisioni Evropian paraqiti planin final bëri që publiku i gjerë në Kosovë të shprehë pakënaqësi të mëdha. Diskursi negativ politike dhe ndjenja e "humbjes së tokave" në kufirin me Malin e Zi rezultoi në protesta, debate politike dhe në fund stagnimin e gjithë këtij procesi. Përkatësisht, diskursi politik për këtë çështje, përcjellur nga protesta të opozitës në Prishtinë është përdorë si një argument nga të anketuarit për të justifikuar konotacionin negativ ndaj Malit të Zi.

FIGURA2 PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ MAQEDONISË DHE MALIT TË ZI



KAPITULLI II

2. PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ "FUQIVE TË MËDHA"

Krahas shteteve fqinje të Kosovës, të anketuarit janë pyetur për të ndarë perceptimet e tyre rreth shteteve të tjera, përkatësisht fuqitë kryesore që kanë ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në procesin e shtetndërtimit të Kosovës dhe të ardhmen e saj. Ndërsa perceptimet ndaj vendeve fqinje kanë reflektuar një përzierje të opinioneve politike, sociale dhe kulturore, nga ana tjetër, perceptimet ndaj fuqive të mëdha janë të bazuara kryesisht në qëndrimin e këtyre vendeve ndaj statusit politik dhe shtetësisë së Kosovës. Roli i medias nuk duhet të injorohet, pasi opinionet e të anketuarve rreth fuqive të mëdha në botë konsiderueshëm janë formuar nga mediat dhe diskursi i përgjithshëm publik.

Siç do të shihet në seksionin e më poshtëm, ka një dallim të qartë të perceptimeve ndaj shteteve perëndimore, duke përfshirë Turqinë, nga njëra anë, dhe Rusinë e Kinën, në anën tjetër. Përderisa shtetet perëndimore janë parë me një lente pozitive, ekziston një mungesë e entuziazmit ndaj Rusisë dhe Kinës, me përjashtim të vogël në rastin e respondentëve serbë të Kosovës.

2.1. Perceptimet e publikut ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Gjermanisë

Ngjashëm me rezultatet e BKS-së 2014, ShBA dhe Gjermania kryesojnë listën duke u perceptuar si shtetet më miqësore ndaj Kosovës. Mbi 90 për qind e të anketuarve kanë listuar të dy vendet si miqësore ose shumë miqësore duke shënuar një rritje të lehtë në krahasim me vitin e kaluar. Statistikisht, ekziston një shkallë e gjerë e mbështetjes ndaj ShBA nga 91.4 për qind e respondentëve që kanë listuar SHBA-të si një shtet mik (70.7 perqind prej tyre e ka konsideruar si shumë miqësore, ndërsa 20.7 për qind e ka konsideruar atë si një shtet mik). Ngjashëm më ShBA-të, Gjermania është konsideruar si miqësore nga 91.9 për qind e të anketuarve (54.2 prej të cilëve e kanë konsideruar si një shtet shumë miqësorë dhe 37.7 si shtet miqësor) ndaj Kosovës. Perceptimi pozitiv kundrejt këtyre shteteve shkon përtej çështjeve bilaterale, në këtë mënyrë, SBA dhe Gjermania janë perceptuar si partnerët dhe aleatët kryesorë në procesin e integrimit euro-atlantik të Kosovës, si dhe në mbështetjen e tyre të përgjithshme në arenën ndërkombëtare.

Ekziston edhe një gamë të gjerë e faktorëve të tjerë që kontribuojnë në qasjen pozitive ndaj këtyre shteteve kryesisht të bazuara në mbështetjen politike në 15 vitet e fundit, duke përfshirë periudhat gjatë konfliktit deri në ditët e sotme. Kujtimet duket të jenë ende të freskëta në mendjet e qytetarëve të Kosovës. Të anketuarit kanë theksuar qëndrim pozitiv ndaj ShBA-së për shkak të mbështetjes së dhënë nga Qeveria e ShBA-së në kuadër të NATO-s, dhe më vonë në sferën diplomatike dhe rolin proaktiv në mbështetjen e procesit të pavarësisë dhe të shtet-ndërtimit të Kosovës.

Përderisa të anketuarit e shohin SHBA si aleat kryesor global, në rastin e Gjermanisë, trendet tregojnë se qytetarët e Kosovës e perceptojnë Gjermaninë si aleat të tyre kryesor në Evropë, me sa duket, politika e jashtme gjermane ndaj Kosovës dhe Serbisë (kushtëzimit për anëtarësim në BE) ka kontribuar në këtë trend pozitiv. Një tjetër faktor kontribues që ka ndikuar në pikëpamjet pozitive për Gjermaninë është diaspora kosovare në Gjermani dhe remitancat e dërguara në Kosovë nga Gjermania. Në këtë drejtim, vlen të përmendet se qasja "tolerancë zero" i qeverisë gjermane ndaj azilkërkuesve ekonomike nga Kosova në vitin e kaluar nuk ka ndryshuar perceptimet pozitive ndaj këtij shteti.

Trendet negative ndaj SHBA dhe Gjermania i atribuohen kryesisht të anketuarve serbë të Kosovës. Të dhënat kualitative të mbledhura në terren tregojnë se pavarësisht perceptimit pozitiv për ShBA dhe Gjermaninë si shtete mike ndaj Kosovës si shtet, ata ende kanë shprehur rezerva ndaj të dyja, ShBA-së dhe Gjërmanisë.

FIGURA3 PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ SHBA-SË DHE GJERMANISË



2.2. Perceptimet e publikut ndaj Mbretësisë së Bashkuar dhe Turqisë

Mbretëria e Bashkuar dhe Turqia janë grupi i dytë i shteteve që me rezultate janë rradhitur pothuajse të barabarta në aspektin e perceptimit e të anketuarve, më saktësisht mbi 80 për qind e tyre kanë ndarë mendime pozitive për të dyja këto shtete. Përderisa rezultatet tregojnë ngjashmëri, faktorët që çojnë në perceptime të tilla pozitive janë ndërtuar në baza kryesisht të ndryshme. Është e qartë se në sytë e qytetarëve të Kosovës, Mbretëria e Bashkuar dhe Turqia shihen si partnerë strategjik të Kosovës.

Përderisa shumica e të anketuarve tregojnë vlerësim ndaj mbështetjes së pakursyer të Mbretësisë së Bashkuar gjatë luftës, mendimet e tyre janë të formuar kryesisht nga mbështetja e Mbretësisë së Bashkuar gjatë periudhës pas pavarësisë dhe për procesin e shtetndërtimit. Për më tepër, Mbretëria e Bashkuar shihet si aleati më i madh SHBA në Evropë, duke reflektuar mbështetje politike ndaj Kosovës në përgjithësi. Në terma statistikorë, 83.9 për qind e të anketuarve të ndajnë perceptime pozitive ndaj Mbretësisë së Bashkuar , e përcjellur nga 12.3 për qind që e perceptojnë atë si neutral ndaj Kosovës, ndërsa vetëm 2 për qind besojnë se qasja e Mbretërisë së Bashkuar ndaj Kosovës është armiqësore.

Në anën tjetër, faktorët prapa trendeve pozitive në rastin e Turqisë janë kryesisht të bazuara në rritjen e bashkëpunimit ekonomik dhe investimeve turke në Kosovë. Volumi i tregtisë midis Turqisë dhe Kosovës ka qenë 206,5 milionë euro në vitin 2012 (MPJ e Turqisë, 2012). Për më tepër një numër i madh i kompanive dhe bankave turke operojnë në Kosovë, ndërsa aeroporti dhe autostrada janë projekte të udhëhequra nga kompani Turke e që janë të njohura për publikun e gjerë në Kosovë (Philips, 2015). Përveç kësaj, Turqia është një nga të paktat shtete në të cilat kosovarët mund të udhëtojnë pa kufizime të hyrjes; falë marrëveshjes për një regjim pa viza të nënshkruar në vitin 2009 mes dy qeverive (Balkan Insight, 2009). Prandaj, rritja e mobilitetit në mes të Kosovës dhe qytetarëve të turqisë ka ndikuar në rritjen e qasjes pozitive nga këtij shteti, kryesisht në bazë të përvojave personale të të anketuarve.

Nga ana tjetër, 9.9 për qind e të anketuarve perceptojnë Turqinë si shtet neutral, e përcjellur nga 4.1 për qind e të cilëve shohin atë nga një prizëm negativ. Ngurrimi për të parë Turqinë si partner potencial strategjik është vërejtur në mesin e të anketuarve serbë të Kosovës kryesisht si rezultat i mbështetjes së dhënë nga qeveria turke ndaj Kosovës në përgjithësi. Një nivel i skepticizmit është parë në mesin e të anketuarve shqiptarë të Kosovës nxitur nga frika e supozuar e agjendës islamika të Turqisë në Kosovë dhe përhapjen e ideve ekstremiste fetare. Është konstatuar se raportet e disa mediave në këtë drejtim mund të ketë ndihmuar për të formuar një opinion të tillë.

FIGURA 4 PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ MBRETËSISË SË BASHKUAR DHE TURQISË



2.3. Perceptimet e Publikut ndaj Francës dhe Italisë

Në grupin e partnerëve strategjik global për Kosovën, Franca dhe Italia janë renditur si grupi i tretë më miqësorë në sytë e opinionit publik të Kosovës. Rreth 60 për qind e të anketuarve i shohin këto shtete përgjithësisht si miqësore. Qartazi, qytetarët e Kosovës nuk i shohin këto dy shtete në bazë të rolit të shquar në aspektin politik të Kosovës; megjithatë, ekziston një qëndrim solid për shkak të mbështetjes së dhënë gjatë luftës dhe periudhën e pasluftës.

Në këtë listë, Franca është parë nga një këndvështrim pozitiv nga 66.3 për qind e të anketuarve që kanë renditur atë si një shtet mik, ndërsa 28.1 për qind ishin të mendimit se është neutral, nje tjetër grup prej 4.4 për qind besojnë që Franca është një vend armiqësor. Me sa duket pakënaqësia kryesore ndaj Francës është shprehur për shkak të mosefikasitetit të trupave franceze (pjesë e KFOR-it) në parandalimin e ndarjes së Mitrovicës në vitin 1999. Nga ana tjetër, një pjesë e madhe e të anketuarve theksuan qasjen e përgjithshme pozitive të diplomacisë franceze në drejtim të procesit të pavarësisë dhe shtet-ndërtimit të Kosovës.

Për sa i përket Italisë, edhe pse ky shtet nuk është perceptuar si një partner i rëndësishëm në agjendën e Kosovës në BE, perceptimet e përgjithshme ndaj këtij shteti janë pozitive. Deri në 67 për qind e të anketuarve e shohin Italinë si shtet miqësor ndaj Kosovës, kryesisht për shkak të mbështetjës që tregoi gjatë luftës dhe në periudhën e pas-pavarësisë së Kosovës, e përcjellur nga 27.7 për qind që besojnë që Italia është një shtet neutral ndaj Kosovës. Ndërsa, vetëm 2.2 përqind ndajnë perceptime negative ndaj Italisë.

FIGURA 5 PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ FRANCËS DHE ITALISË



2.4. Perceptimet e publikut ndaj Rusisë dhe Kinës

Ndryshe nga perceptimet lidhur me grupin e lartpërmendur të shteteve të cilat kanë qenë kryesisht të perceptuara pozitivisht, opinionet lëvizin në drejtim të anës negative kur është fjala për Rusinë dhe Kinën. Me sa duket, këto shtete nuk duket gëzojnë shumë popullaritet në mesin e qytetarëve të Kosovës. Të vendosura gjeografikisht larg nga Kosova, perceptimet ndaj këtyre shteteve janë ndërtuar kryesisht në bazë të qasjes së tyre ndaj pavarësisë dhe statusit politik të Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Rusia është konsideruar si një shtet armiqësor nga 86.7 për qind e të anketuarve, e përcjellur nga 8.5 që besojnë se është neutrale ndaj Kosovës dhe vetëm 3.2 për qind kanë listuar atë si një shtet mik. Mendimet pozitive në lidhje me Rusinë janë pasqyruar në mesin e të anketuarve serbë të Kosovës që morën pjesë anketim. Tendencat negative në mesin e shqiptarëve të Kosovës në drejtim të Rusisë mund të shpjegohen edhe nga lidhjet e ngushta që ky shtet ka me Serbinë dhe mbështetjen e vazhdueshme politike ndaj Serbisë veçanërisht në lidhje me rastin e Kosovës. Duke u perceptuar si aleati më i madh serb në arenën ndërkombëtare, Rusia është kualifikuar si "dora e Serbisë" e cila përdoret kryesisht për të bllokuar anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Kjo është parë edhe në çdo përpjekje që Kosova bën drejt aspiratës për t'u bërë anëtare e OKB-së ose ndonjë nga agjensionet e saj; Rusia në këto raste ka qenë një mbështetëse e fortë e Serbisë duke përdorur fuqinë e saj si anëtare e përhershme e Këshillit të Sigurimit të vërë veton ndaj çdo iniciative që do të mbështeste legjitimitetin ndërkombëtar të Kosovës.

Ngjashëm më rastin e Rusisë, Kina është perceptuar si një vend armiqësor ndaj Kosovës nga 65 për qind e të anketuarve të cilët e kanë konsideruar qasjes e Kinës ndaj Kosovës si armiqësore, e përcjellur nga 26.4 për qind të cilët e konsiderojnë atë si neutrale, dhe 5.6 për qind miqësore. Kina, gjithashtu, është parë si një pengesë në arenën ndërkombëtare. Hezitimi i Kinës për të njohur pavarësinë e Kosovës dhe vetoja e saj në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KSKB) ka ndikuar shumë mendimin e qytetarëve të Kosovës në drejtim të Kinës. Në përgjithësi, mendimet drejt Kinës janë ndërtuar në bazë të ndikimit të tij dhe pozitën në kuadër të OKB-së, dhe jo domosdoshmërisht në bazë të praktikës apo përvojave personale që kosovarët kanë me këtë shtet. Përkundër një mendimi të përgjithshëm negativ kundrejt Kinëa, ajo ende renditet më mirë se Rusia, dhe kjo mund të shpjegohet nga dy faktorë. Së pari, Kina nuk është perceptuar si një mbështetës i patundur i Serbisë siç është Rusia. Së dyti, janë dinamika e lartë tregtare dhe komerciale në mes Kosovës dhe Kinës, dhe ka raportime se kosovarët ende mund të udhëtojnë për në Kinë për të bërë biznes, ndërsa ata nuk kanë asnjë shans për të vepruar kështu, kur është fjala për Rusinë.

FIGURA 6 PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ RUSISË DHE KINËS



KAPITULLI III

3. PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE DHE PERSPEKTIVA EURO-ATLANTIKE E KOSOVËS

Krahas me shtetet më relevante për Kosovën, të anketuarit janë pyetur për të dhënë opinionin e tyre për organizatat ndërkombëtare në të cilat Kosova qartazi aspiron anëtarësimin. Opinionet dhe perceptimet e dhëna në këtë seksion janë të ndikuara shumë nga misionet që këto organizata drejtojën dhe përfaqësojnë në Kosovë, disa prej tyre ende e pranishme në Kosovë me misione aktive.

3.1. Perceptimet e publikut ndaj NATO-s, BE-së dhe OKB-së

Ngjashmërisht me rezultatet e mëparshme BKS-së, NATO vazhdon të mbetet organizata ndërkombëtare më miqësore në sytë e qytetarëve të Kosovës. Në përgjithësi, qëndrimi pozitiv është i bazuar në ndërhyrjen ushtarake të NATO-s në Kosovë gjatë luftës së vitit 1999; ky përceptim pozitiv ka vazhduar të rritet edhe më tej nga prania e KFOR-it, si një pasardhës i NATO-s duke ofruar siguri në Kosovë. NATO është perceptuar si një organizatë ndërkombëtare me qasje positive ndaj Kosovës nga 87.9 për qind e të anketuarve, ndërsa 9.5 për qind e shohin atë si neutral. Ata që nuk ndajnë një mendim pozitiv në lidhje me NATOm perceptimet e tyre I kanë bazuar kryesisht në qëndrimin status neutral të NATO-s ndaj Kosovës. Vetëm 1.7 për qind e respodentëve e përceptojnë NATO-n si një organizatë armiqësore, rezultat i cili reflektohet më së shumti nga të anketuarit serbë të Kosovës.

Kur u pyetën në lidhje me qasjen e BE-së ndaj Kosovës, të gjeturat tregojnë se ka një perceptim pozitiv solid drejt BE-së. Prandaj, 68 për qind e të anketuarve e shohin BE-në si një organizatë miqësore, ndërsa 27.4 për qind e shohin atë si neutrale, e përcjellur nga 3.0 për qind që e konsiderojnë qasjen e BE-së si armiqësore ndaj Kosovës. Rezultatet tregojnë se përkundër zhgënjimit konsekuent dhe mungesa së "karrotave", të dhëna nga BE-ja, qytetarët e Kosovës ende e shohin këtë strukturë nga një prizëm pozitiv; opinioni pozitiv mund të shpjegohet me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) të arritur ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe të BE-së (Komisioni i BE-së, 2015),

dhe mënyrën se si ajo është paraqitur në media. Ndërsa ata që e kanë listuar BE-në si një organizatë neutrale dhe armiqësore kanë dhënë një listë të argumenteve me pritshmëritë e tyre që BE-ja ka dështuar të i përmbush, çështje të tilla siç janë: mungesa e liberalizimit të vizave; qasja e vazhdueshme status-neutral e BE-së ndaj Kosovës; dhe vështirësitë në sigurimin e zbatimit të marrëveshjeve me Serbinë.

Pothuajse trende të ngjashme mund të shihen në lidhje me OKB-së; rezultatet tregojnë se 57.1 për qind e të anketuarve e konsiderojnë OKB-në të jetë një organizatë miqësore, ndërsa 35.1 për qind e konsiderojnë atë si neutrale ndaj Kosovës, e ndjekur nga 3.6 për qind që e perceptojnë atë si armiqësore. Qasja pozitive mund të shpjegohet me dëshirën e përgjithshme në mesin e kosovarëve për t'u bërë anëtare e OKB-së në mënyrë që Kosovo t'I bashkohet shteteve të tjera, si subjekte të barabarta. Nga ana tjetër, një numër i konsiderueshëm i të anketuarve që konsiderojnë se OKB-ja është organizatë neutrale ndaj Kosovës tregojnë qartë që kanë bërë një lidhje në mes të misionit të UNMIK-ut në Kosovë dhe OKB-së, e cila në mënyrë të qartë ka ndikuar drejtpërdrejt mendimin e kosovarëve.

FIGURA 7 PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ NATO-S, BE-SË, DHE OKB-SË



3.2. Perceptimet e publikut ndaj partnerëve potencial strategjik të Kosovës

Për herë të parë në kuadër të edicionit të pestë të BKS-së, të anketuarit janë pyetur për të dhënë mendimet e tyre në lidhje me rrjedhat që duhet të ndjekë politika e jashtme e Kosovës. Duke qenë se Kosova po qëndron në prag të vendosjes së marrëdhënieve kontraktuale me BE-në, partneritetit të ngushtë dhe tepër të fortë me SHBA-të, dhe

së fundmi, kryesisht ekonomike, vendosja e marrëdhënieve me Turqinë, të anketuarit janë pyetur të rendisin partnerët e mundshëm strategjik për Kosovën.

Në mesin e tri opsioneve: anëtarësimit në BE, partneritetit me SHBA, dhe forcimit të mëtejmë të marrëdhënieve me Turqinë, dukshëm anëtarësimi në BE ka marrë përgjigjet më pozitive nga shumica e të anketuarve, më saktësisht na 94 për qind e tyre, ndërsa vetëm 5.0 për qind besojnë se Kosova nuk duhet të anëtarësohet në BE. Duke qëndruar në përputhje me prioritetet dhe aspiratat e Qeverisë së Kosovës, qytetarët e Kosovës e perceptojnë anëtarësimin në BE, si një nga rrugët më të rëndësishme diplomatike që Kosova duhet të marrë. Në mënyrë të ngjashme, ruajtja e partneritetit me SHBA është konsideruar e rëndësishme nga 92.6 për qind e të anketuarve, e përcjellur nga 1.3 për qind të cilët ndajnë perceptimet negative, dhe me një grup tepër të madh të të anketuarve, përkatësisht 6.1 për qind që ishin të gatshëm për të dhënë mendimin e tyre lidhur me këtë çështje. Sa i përket Turqisë, deri në 83.1 për qind e të anketuarve besojnë që Kosova duhet të forcojë partneritetin e saj me Turqinë, kryesisht bazuar në faktorin ekonomik. Ndërsa, 13.8 për qind e të anketuarve kanë treguar hezitim kryesisht duke shfaqur frikë nga faktori fetar, dhe dyshimet për një agjendë të supozuar islamike prapa partneritetit me këtë shtet, me disa prej tyre që kanë parë Turqinë si më pak "fuqi" të rëndësishme në arenën ndërkombëtare.

FIGURA 8 PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ PARTNERËVE STRATEGJIK PËR KOSOVËN



3.3. Perceptimet e publikut ndaj anëtarësimit të Kosovës në BE

Pasi që integrimi dhe anëtarësimi në BE përbën një nga shtyllat kryesore të politikës së jashtme të Kosovës, matja e perceptimeve ndaj procesit të integrimit në BE ka qenë një nga çështjet kyçe në të gjitha edicionet BKS-së. Me sa duket, qytetarët e Kosovës kanë ndarë perceptime pozitive në lidhje me procesin e integrimit në BE përgjatë pesë

edicioneve të fundit të BKS-së duke treguar në mënyrë të qartë një nivel të madh të entuziazmit ndaj këtij procesi.

Një trend dhe qëndrim pozitiv ndaj integrimit në BE është treguar përgjatë viteve, me një rritje të lehtë me 4 për qind në krahasim me vitin e kaluar. Deri në 94 për qind e të anketuarve besojnë dhe janë të gatshëm të bashkohen me BE-në edhe pse është një qëllim "shumë i largët" për Kosovën duke pasur parasysh reformat dhe numrin e kushteve që duhet të plotësohen, si dhe faktin e shanseve të zbehta për shkak të mos-njohjes nga të gjitha shtetet e BE-së. Me sa duket, stagnimi i zgjerimit të BE-së për pesë vitet e ardhshme, siç u potencua nga komisioneri i BE-së Johannes Hahn (Economist, 2015), nuk ka arritur të ndryshojë mendim pozitiv drejt anëtarësimit në BE. Nga ana tjetër, vetëm 5.0 për qind e të anketuarve kundërshtojnë anëtarësimin e Kosovës në BE duke pasur parasysh se konsiderojnë se përpara se të kërkohet anëtarësim të Kosovës në BE, duhet të arrihet pjekuri politike dhe stabilitet të brendshëm.

FIGURA 9 PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ ANËTARËSIMIT TË KOSOVËS NË BE



Trendi pozitiv duket të jetë i pranishëm në mesin e qytetarëve të Kosovës edhe përkundër rezervave që shfaqen në lidhje me qasjen e BE-së ndaj Kosovës. Kur u pyetën në lidhje me qasjen e BE-së ndaj Kosovës, afërsisht gjysma e të anketuarve besojnë se qasja e BE-së është konstruktive dhe gjysma tjetër mendon se BE-ja nuk ka qenë konstruktive ndaj Kosovës. Duket se gjysma e të anketuarve besojnë se BE-ja ka një poltikë dhe qasje "karrotë dhe shkop" shumë mirë të llogaritur, duke balancuar numrin e "shkopinjëve" me numrin e "karrotave" dhënë Kosovës në procesin e integrimit në BE. Ky numër është pasuar nga 28.1 për qind e respodentëve që besojnë se BE-ja ka një qasje konstruktive ndaj Kosovës, kjo qasje pozitive mund t'i atribuohet nënshkrimit të MSA-së, e cila u konsiderua si një nga sukseset më të mëdha, dhe si një marrëveshje historike e arritur në procesin e integrimit të Kosovës në BE.

Në anën tjetër, 15.1 për qind besojnë se BE-ja nuk është konstruktive në qasjen e saj ndaj Kosovës. Rezervat vijnë si rezultat i zhgënjimit të vazhdueshëm në procesin e liberalizimit të vizave, që ka privuar kosovarët nga liria e lëvizjes në vendet e BE-së. Faktori i dytë është i shtyrë nga paaftësia e BE-së për të siguruar zbatim më të mirë të marrëveshjeve që rrjedhin nga dialogu Kosovë-Serbi, dhe qasja neutrale që BE-ja e ka ndaj Kosovës në këtë proces.

Pavarësisht disa nga dilemat, gjetjet tregojnë se qytetarët e Kosovës ende e konsiderojnë BE-në si një partner të rëndësishëm dhe si një alternativë për zgjidhjen e problemeve ekonomike, politike dhe të sigurisë.

FIGURA 10 PERCEPTIMET E PUBLIKUT PËR QASJEN E BE-SË NDAJ KOSOVËS



3.4. Perceptimet e publikut ndaj anëtarësimit në NATO

Në përputhshmëri me agjendën euro-atlantike, një shumicë dërrmuese e të anketuarve ose 89.0 për qind mendojnë se Kosova duhet të bëhet anëtare e NATO-s. Përkundër qasjes neutrale të NATO-s ndaj Kosovës dhe mungesës së marrëdhënieve zyrtare me Kosovën, dëshira për t'u bërë pjesë e kësaj strukture është mjaft e lartë. Pa dyshim, NATO gëzon një nivel të shëndoshë të besimit në mesin e qytetarëve të Kosovës kryesisht në bazë të ndërhyrjes ushtarake gjatë luftës në vitin 1999. Opinionet janë formësuar edhe më tej edhe nga prezenca e KFOR-it në Kosovë. Për më tepër, anëtarësimi në NATO duket të jetë i lidhur me aspiratën për të poseduar një forcë solide të armatosur që do të punojë së bashku me anëtarët e tjerë të NATO-s në arenën ndërkombëtare.

Nga ana tjetër, 8.8 për qind e të anketuarve kundërshtojnë anëtarësimin në NATO; perceptimi negativ është i pranishëm kryesisht në mesin e të anketuarve serbë të Kosovës të cilët në mënyrë të prerë kundërshtojnë integrimin e Kosovës në NATO.

FIGURA 11 PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ ANËTARËSIMIT TË KOSOVËS NË NATO



KAPITULLI IV

4. PERCEPTIMET E PUBLIKUT NDAJ DIALOGUT POLITIK ME SERBINË

Gati pesë vite pas fillimit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, si në nivelin teknik dhe politik, ky proces afatgjatë dhe i vështirë ka nxitur shumë debate të nxehta në mesin e elitës politike në Kosovë dhe qytetarët e Kosovës. Përgjigjet e këtij sondazhi variojnë nga ato që debatojnë nëse Kosova duhet të vazhdojë dialogun me Serbinë, nëse Kosova duhet të ndryshojë qëndrim në këto bisedimeve, dhe kështu me radhë. Shumë dyshime në lidhje me procesin janë ngritur nga këndvështrime të ndryshme të të dyja palëve, shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës.

Pyetja nëse Kosova po përfiton nga ky proces ka shkaktuar ndarje të mëdha në mes të qeverisë dhe opozitës në Kosovë, si dhe protestat masive kanë sjellur grupe të mëdha të njerëzve në kryeqytet. Pakica serbe e Kosovës, në anën tjetër, e percepton dialogun si një proces pozitiv, duke pritur që t'i përmirësojë jetën e tyre në Kosovë, edhe pse është një proces i kushtueshëm duke pasur parasysh se përfaqëson një hap përpara në njohjen e shtetësisë së Kosovës nga ana e Serbisë - në bazë të perceptimeve të tyre.

4.1. Dialogu politik në mes të Kosovës dhe Serbisë: Kush është fituesi?

Pothuajse të gjitha marrëveshjet që janë arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë janë interpretuar ndryshe nga palët e përfshira në proces, si vetë BE-ja si palë ndërmjetësues. Mungesa e transparencës gjatë gjithë procesit, dhe vendimmarrja pas "dyerve të mbyllura", kanë krijuar vakum dhe hapsirë për keqinterpretim, keqpërdorim të përmbajtjes së marrëveshjeve nga ana e elitave politike në të dy vendet, si dhe ka penguar shumë aspekte të zbatimit të marrëveshjeve dhe impaktin e mundshëm në jetën e qytetarëve. Si pasojë, kjo çoi në një rritje të konfuzionit në mesin e të anketuarve të dy palëveshqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës, siç shihet në figurën 13.

Kur u pyetën se kush po përfiton më shumë nga dialogu në mes Kosovës ose të Serbisë, pothuajse gjysma e të anketuarve, ose 45.3 për qind e tyre besojnë se Serbia po përfiton më shumë se Kosova. Shumica e argumenteve të përdorura nga të anketuarit ishin të lidhura me rrugën e përshpejtuar të Serbisë drejt BE-së, ndërsa në të njëjtën

kohë Kosova ka stagnuar në këtë proces, si dhe numri i madh i përfitimeve që Serbia ka qenë e nxjerrjes nga ky proces. Me Kosovën që ka mbetur jashtë regjimit të lirë të vizave, dhe me Serbinë, në anën tjetër, ka hapur kapituj me rëndësi në procesin e anëtarësimit në BE, të anketuarit shqiptarë të Kosovës besojnë se Kosova po bëhet e përdoret si mjet për të lehtësuar rrugën e Serbinë drejt anëtarësimit në BE.

Nga ana tjetër, vetëm 12.7 përqind e të anketuarve besojnë se Kosova është duke përfituar më shumë se Serbia në këtë proces. Faktorët prapa qëndrimeve të tilla janë të lidhura kryesisht me MSA-në, duke besuar që kjo marrëveshje shënon marrëdhënien e parë kontraktuale midis Kosovës dhe BE-së dhe që është një marrëveshje historike në rrugën e Kosovës drejt BE-së. Përveç kësaj, shumica e të anketuarve që besojnë se Kosova është duke përfituar më shumë se Serbia deklaruan se dialogu në fund do të rezultojë me njohjen e pavarësisë së Kosovës nga autoritetet serbe. Kjo është problematike, sepse kjo tregon se edhe kjo përqindje e vogël e njerëzve që besojnë se Kosova është duke përfituar më shumë se Serbinë, lehtë mund të zhvendosë mendimin e tyre në drejtim të kundërt, kur bëhet e qartë se procesi në të vërtetë nuk çon në drejtim të asaj që ata janë duke shpresuar për - një shans i madh për të ndodhur kjo në të ardhmen e afërt. Nga ana tjetër, ky opinion pozitiv mund të forcohet edhe më tej në të ardhmen në varësi të përmbajtjes së kapitullit 35 të negociatave për anëtarësim BE-së me Serbinë, e cila kryesisht ka të bëjë me normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën para se të hyrjes së Serbisë në BE. Ky proces është, megjithatë, shumë i gjatë për të mbajtur një opinion të tillë poziitv.

Nga ana tjetër, më pak se një e katërta e të anketuarve ose 22.6 për qind e tyre besojnë se dialogu është një situatë të favorshme për të dy palët, Kosovën dhe Serbinë, dhe që të dy pa;ët po përfitojnë në mënyrë të barabartë duke fituar shumë në procesin e integrimit në BE. Një mendim krejtësisht të kundërt është e ndarë nga 15.7 për qind e të anketuarve të cilët besojnë se as Kosova e as Serbia po përfitojnë nga ky proces.

FIGURA 12 PERCEPTIMET E PUBLIKUT PËR REZULTATIN E DIALOGUT NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË



FIGURE 13 PERCEPTIMET E SHQIPTARËVE DHE SERBËVE PËR REZULTATIN E DIALOGUT NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË



4.2. (Mos) arritja e normalizimit

Të pyetur nëse dialogu ka kontribuar në normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, shumica e të anketuarve besojnë se dialogu po dështon për të arritur qëllimin gjithëpërfshirës - normalizimin e vërtetë të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Statistikisht, 55.9 për qind e të anketuarve janë pesimistë në këtë drejtim, duke besuar se situata nuk ka ndryshuar nga para fillimit të dialogut, dhe se marrëdhëniet nuk janë normalizuar. Pjesa më e madhe e të anketuarve besojnë se dialogu është një proces politik I shkëputur nga realiteti në Kosovë; prandaj ka dështuar për të siguruar progres në përmirësimin e jetës së qytetarëve, si për shqiptarët e Kosovës dhe për serbët e Kosovës.

Në anën tjetër, më shumë se një e katërta e të anketuarve, ose 37.7 për qind kane deklaruar se marrëdhëniet janë normalizuar, e përcjellur nga një numër i vogël i të anketuarve, ose një total prej 4.6 për qind të cilët kanë deklaruar se marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë janë normalizuar .

FIGURA 14 PERCEPTIMET E PUBLIKUN PËR NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË



Duke pasur parasysh faktin se marrëveshjet e shumta që rrjedhin nga dialogu janë të lidhura direkt me jetën e pakicës serbe në Kosovë, veçanërisht në pjesën veriore të Kosovës, të anketuarit serbë të Kosovës kanë mendime pozitive për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. 57.3 për qind kanë deklaruar se marrëdhëniet janë normalizuar pak, e ndjekur nga 37.8 që besojnë se situata nuk është normalizuar dhe mbetet e njëjtë.

FIGURA 15 PERCEPTIMET E SHQIPTARËVE DHE SERBËVE PËR NORMALIZIIN E MARRËDHËNIEVE NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË



4.3. Perceptimet e publikut për krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe

Marrëveshja për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe (AKSS) u arrit dhe nënshkrua nga autoritetet kosovare dhe serbe në Gusht të vitit 2015, si pjesë e dialogut Kosovë-Serbi në Bruksel (Komisioni, 2015).

Nuk ka kaluar kohë e gjatë para se kjo çështje të arrijë kulmin e debateve të nxehta politike mbi përmbajtjen e marrëveshjes në mes qeverisë dhe opozitës në Prishtinë. Si pasojë, kjo u bë një nga arsyet që çuan në krizën politike në Kosovë dhe është manifestuar me rrijte të pakënaqësisë me qeverinë, benefitet që sjellin bisedimet, dhe të ardhmen e shtetit multi-etnik të krijuar në vitin 2008. SI pasojë, ky edicion I BKS-së ka vazhduar të ekzaminojë një nga çështjet më të debatueshme që ka derivuar nga dialogu Kosovë - Serbi. Pasi që hulumtimi në terren u zhvillua në tetor, perceptimet janë mbledhur në mes të diskutimeve të mëdha lidhur me këtë çështje, dhe protestave të mëdha të zhvilluara në kryeqytet.

Në përgjithësi, gjetjet pasqyrojnë situatën politike në Kosovë; një shumicë dërrmuese e të anketuarve, ose 71.7 për qind e tyre kanë qëndrim negativ sa i përket themelimit të AKSS duke e parë atë si shumë të dëmshme dhe të dëmshme për Kosovën. Vlen të përmendet se finalizimi i marrëveshjeve dhe detajet e publikuara të përmbajtjes së saj kanë zemëruar respondentët shqiptarë në Kosovë. Përveç kësaj, rritja e vetëdijes për këtë marrëveshje, duke qenë çështja më e diskutuar në media dhe në mesin e politikanëve, ka kontribuar në një rritje të trendit negativ me rreth 10 për qind në krahasim me rezultatet e mëparshme të BKS-së. Vlen të përmendet se ky diskurs, mungesa e transparencës dhe pasiguria në këtë proces është një nga faktorët kryesor pse qytetarët e Kosovës e kanë vlerësuar këtë çështje me inercion, dhe jo domosdoshmërisht bazuar në përmbajtjen e marrëveshjes.

Nga ana tjetër, 16.2 për qind e të anketuarve kanë një perceptim të balancuar ndaj AKSS, ndërsa vetëm 7.8 për qind besojnë se zbatimi i tij është pozitiv. Nga reagimet e të anketuarve, del se serbët e Kosovës në përgjithësi të ndajnë pikëpamjet pozitive, ndërsa shqiptarët besojnë se krijimi i AKSS cenon rëndë rendin kushtetues të Kosovës dhe stabilitetin e vendit. Në përgjithësi, një 4.0 për qind, nga të gjitha etnitë nuk ka dashur të përgjigjet dhe as nuk kishte asnjë informacion mbi këtë çështje.

FIGURA 16 PERCEPTIMET E PUBLIKUT PËR KRIJIMIN E ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE



Nga ana tjetër perceptimi pozitiv i pakicës serbe në Kosovë në lidhje me këtë çështje është mjaft e fortë, duke qenë 60,98 për qind në total perceptojnë marrëveshjen për AKSS pozitivisht, e përcjellur nga 23.17 për qind të cilët mendojnë se është neutralë; megjithatë ka një rritje të vogël në qëndrimin pozitiv në krahasim me rezultatet e BKS 2014. Nga ana tjetër, 9.76 për qind e të anketuarve serbë të Kosovës ndajnë perceptime negative ndaj AKSS. Qëndrimet prapa përceptimeve negativë përfshinin argumente të tilla si mungesa e besimit ndaj të gjithë procesit; për më tepër shumë prej të anketuarve mendojnë se ekzistenca e AKSS nuk do të ndikojë aspak në jetët e tyre.

FIGURA 17 PERCEPTIMET E SHQIPTARËVE DHE SERBËVE PËR KRIJIMIN E ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE



REFERENCAT

Commission, E. (2015). *Associa'on/Community/of/ Serb/majority/municipali'es/in/ Kosovo/–/general/*. Retrieved December 15, 2015, from http://eeas.europa.eu/statements-eeas/docs/150825_02_association-community-of-serb-majority-municipalities-in-kosovo-general-principles-main-elements_en.pdf

Commission, E. (2015). *European Commission* . Retrieved December 15, 2015, from http://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2015/10/27-kosovo-eu-stabilisation-association-agreement/

Economist, T. (2015). *The western Balkans and the EU in the queue*. Retrieved December 15, 2015, from http://www.economist.com/news/europe/21620264-door-membership-remains-open-region-must-do-more-get-it-queue

Insight, B. (2009). *Kosovo, Turkey Sign Visa-Free Travel Pact*. Retrieved December 15, 2015, from http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-turkey-sign-visa-free-travel-pact

MFA, T. (2012). *Republic of Turkey - Ministry of Foreign Affairs*. Retrieved December 15, 2015, from http://www.mfa.gov.tr/relations-between-turkey-and-kosovo_.en.mfa

Philips, D. L. (2015). *Huffington Post - Turkey's Islamist Agenda in Kosovo*. Retrieved December 15, 2015, from http://www.huffingtonpost.com/david-l-phillips/turkeys-islamist-agenda-i_b_8891634.html

Vrajolli, M., & Kryeziu, S. (2015). *Kosovar Security Barometer - Fifth Edition.* Prishtina : Kosovar Centre for Security Studies (KCSS).

Falemnderim

Dëshirojmë t'ju shprehim mirënjohje të veçantë të gjithë ata që kontribuuan në këtë studim, si dhe për rolin e rëndësishëm në kryerjen e hulumtimeve në terren, mbikëqyrjen dhe monitorimin e përpunimit të të dhënave.

Ekipi e kishte këtë përbërje:

Alba Boshnjaku, Adnan Kryeziu, AgnesaHaxhiu, AgonAhmeti, AlbinëBricori, Andi Emini, ArgjiraKameri, Arian Mavriqi, DiellzaKosumi, DurimXhemajli, Erna Buçaj, GëzimStavileci, Granit Hyseni, GresaSermaxhaj, KastriotGrapci, KujtimKryeziu, Kushtrim Mustafa, LirimKrasniqi, MalisaZymberi, MarigonaDubovci, Milan Lazarevic, PremtimFazlija, RinaKoleci, RinonArifi, Rita Nushi, Roland Sylejmani, RronGashi, TaulantBoshnjaku, ValëzaMjeku, Verona Kadriu, YllzaXheladini

Publikimet e mëparshme në kuadër të Barometrit Kosovar të Sigurisë

Barometri Kosovar i Sigurisë - Edicioni i Pestë, Dhjetor 2015

Trendet e besueshmërisë së qytetarëve ndaj institucioneve të sigurisë dhe të drejtësisë në Kosovë, Shtator 2015

Perceptimet e Qytetarëve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Janar 2015

Perceptimet e Publikut për Politikën e Jashtme dhe Dialogu me Serbinë, Janar 2015

Barometri Kosovar I Sigurisë - Edicioni i Katërt, Dhjetor 2014

Barometri Kosovar i Sigurisë - Edicioni i Tretë, Dhjetor 2013

Barometri Kosovar i Sigurisë: Edicion Special, Nëntor 2013

Barometri Kosovar i Sigurisë - Zërat e Kosovës: Vështrimet dhe Perceptimet, Maj 2013

Barometri Kosovar i Sigurisë - Edicioni i Parë, Dhjetor 2012

Publikimet e ardhshme në kuadër të Barometrit Kosovar të Sigurisë

Perceptimet e Qytetarëve për Integritetin e Policisë në Kosovë, Shkurt 2016

Perceptimet e Qytetarëve për Sigurinë Publike në Kosovë, Mars 2016

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

351.746.1(496.51)(048)
327(497:496.51)(048)

Barometri i Kosovar i Sigurisë – edicion special / Interpretuese e të dhënave Donika Emini. – Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, , 2016. - 17 f. : ilustr. ; 23 cm.

1.Emini, Donika

ISBN 978-9951-679-35-0

ISBN 978-9951-679-35-0

www.qkss.org